

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Lordi Owen, laburist, ministër i Jashtëm i Britanisë së Madhe, doktor në profesion, ka shkruar një libër shumë interesant “In sickness and in power”, që do të thotë “Të sëmurë në pushtet”. Në një periudhë kohore prej 100 vjetësh ai ka marrë raste të spikatura krerësh qeverish dhe ka nxjerrë konkluzionin se mbizotëruese e sëmundjes (jo klinike, që të mos keqkuptohemi) politike ka qenë sindroma “Hubris”, nga greqishtja e lashtë “ivris”, që është “fyerja”.

Kushdo që pati rastin të ishte i pranishëm në çeljen e seancës plenare sot, paradite, dhe kushdo që e ndoqi atë nëpërmjet medieve, konstatoi demonstrimin më të gjallë të sindromës nga Kryeministri i vendit, i cili hodhi një përriua fyerjesh, sharjesh, ofendimesh, zhvlerësimesh për opozitën. Lordi Owen do të shprehte krenari të pakufishme për saktësinë e konstatimit dhe të përshkrimit, duke parë mishërimin e gjallë të sindromës. Unë nuk pashë asnjë reagim. Si ka mundësi, sidomos zonjat, që kanë një sensibilitet të veçantë, që gjysma e sallës dhe gjysma e shoqërisë i ka mbështetur dhe i ka votuar, të cilësohen të paafta, të pafytyra, pa fe, pa atdhe dhe turp të prindërve të tyre?! Deri kur do të nëpërkëmbet institucioni më i lartë i demokracisë, i Republikës?! U dridhen eshtrat atje ku janë etërve të demokracisë të të gjitha kohërave dhe ju krenoheni?!

Zonja dhe zotërinj, unë jam nga ata që nuk hezitoj ta lavdëroj qeverinë për vendimet e drejta që merr. Nuk e di nëse këtu është zonja ministre e Jashtëme, të cilën dua ta falënderoj dhe ta përgëzoj për kontributin që po jep vendi ynë në Këshillin e Sigurimit, që nuk ka asnjë të krahasuar me periudhën kur kreu i qeverisë kryesonte në OSBE. Ky është një model përfaqësimi në Këshillimin e Sigurimit dhe është nder kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës pohojnë se ndiejnë një aleat luajal, bindës, por kjo nuk është vetëm meritë, është edhe një detyrim. Ne jemi anëtar të NATO-s, apo jo, zoti Majko, nuk kemi vetëm të drejta, kemi edhe detyrime. Ne me qartësinë dhe vendosmërinë më të madhe u pozicionuam kundër agresionit rus në Ukrainë. Është një shkelje flagrante, e pajustificuar, e paprovokuar e së drejtës ndërkombëtare dhe jemi të gjithë aty. Pse, zotërinj, kjo hipokrizi? Këto janë detyrimet dhe të drejtat tona dhe mënyra si i ka demonstruar është meritë e qeverisë, por cili është roli i Kryeministrit të

Republikës së Shqipërisë?! Të bëjë apologjinë e vendeve të tjera, që nuk kanë të njëjtin qëndrim ndaj agresionit rus? Pse zoti Rama bën avokatinë dhe apologjinë e zotit Vuçiç! Sigurisht, jam në vijën e parë për marrëdhënie të mira, të shkëlqyera, bashkëpunimi dhe fqinjësi të mirë, por kemi edhe vijat e kuqe. Cili është roli i Kryeministrit tonë, i cili në Këshillin e Europës, në vend që të prezantonte pikërisht zhvillimet në vendin tonë, u bë avokati i Erdoganit, në një kohë kur Turqia është një shtet që, ashtu si Rusia, po bën invazion në Ukrainë, ka bërë invazion në Republikën e Qipros dhe mban 40% të Qipros së pushtuar, një vend anëtar i Bashkimit Europian, kur ne e duam votën e Republikës së Qipros për çdo hap në procesin tonë të integritetit. Ishte Erdogan ai që Shën Sofinë, simbolin e bashkëjetesës së feve, e riktheu në xhami, kundër vendimeve të Ataturkut. Kur në Turqi politikanë, deputetë të zgjedhur janë të burgosur politikë, kur edhe aktivisti i shquar i të drejtave të njeriut, Kavala, është ende në burg, si i burgosur politik, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë shkon në Këshillin e Europës dhe i bën avokatin autokratit Erdogan. Ju nuk ndiheni! Bojkotohet nga të majtë, nga të djathtë, nga liberalë, nga ekstremi i majtë, nga ekstremi i djathtë, por ju nuk prekeni. Përse i them këto gjëra? Sepse bota sot me invazionin rus në Ukrainë u nda në dy kampe: nga njëra anë qëndron kampi i lirisë, i demokracisë, i shtetit të së drejtës, dhe aty është vendi i Shqipërisë dhe i shoqërisë sonë, nga ana tjetër janë autokratët. Kryeministri ynë flirton me autokracinë. Po e mbyll me këtë.

Për sa i përket buxhetit, për të dhjetin vit radhazi jeni maxhoranca që prezantoni buxhetin në këtë vend. Askush, pas viteve 90', nuk e ka pasur mundësinë që të prezantojë 10 buxhete radhazi për 10 vjet.

Një shifër do të përmend: të ardhurat për frymë në Republikën e Shqipërisë, sipas të dhënave të Eurostatit, janë sa 32% e mesatares së vendeve në Bashkimit Europian. Në Maqedoninë e Veriut janë 42%, në Serbi janë 44% dhe në Mal të Zi janë 47%. Në studim nuk përfshihet Kosova. Pra, jemi vendi më i varfër. Për 10 vjetët e fundit ju nuk keni sjellë asnjë përmirësim, kur qëllimi i administrimit të financave të shtetit është që ta vendosë buxhetin në shërbim të qytetarëve dhe për përmirësimin e jetës së tyre dhe të të ardhurave për frymë të qytetarit shqiptar. E gjetët më të varfrin dhe e lini më të varfrin. Vini këtu dhe justifikoheni për gjëra që nuk ju akuzojnë. Nuk e shkaktuat ju tërmetin; nuk e shkaktuat ju pandeminë; nuk e shkaktuat ju krizën energjetike, por po ju akuzojnë për mënyrën se si i administroni. Çdo krizë, e përsëris, ka humbës dhe fitues. Ju me politikën tuajë për përballimin e çdo krize jeni selektivë, klasorë dhe klientelistë. Ju nuk i prekët PPP-të në buxhetin e këtij viti, por prekët të ardhurat e qytetarëve; ju nuk e vendosni dorën për të ruajtur çmimet; edhe të ardhurat ekstra në buxhetin e shtetit, për shkak të rritjes së çmimeve, nuk i përdorni për të zhdukur pasojat e krizës që nuk e shkaktuat ju.

Edhe një herë, mos e hidhni topin në shkallët e stadiumeve, luani lojën që duhet luajtur, pohoni të vërtetën. Jeni në pozitat e oligarkëve. Por në cilin pozicion? Nuk janë më oligarkët klientët tuaj, por jeni ju veglat e oligarkëve, që ju lëvizin si marioneta në çdo vendim dhe në çdo politikë që hartoni.

Për pjesëtarët e minoritetit grek 10 buxhete të Republikës nuk ishin të mjaftueshme për të bërë një rrugë për të lidhur ish-komunën e Pogonit, ish-komunën e Zagorisë, ish-komunën e Theollogos, të paktën me qendrat e këtyre komunave ose për të lidhur rrugën nacionale me pikën e kalimit kufitar në Drimadhes apo në Theollogos, e kështu me radhë.

Zonja dhe zotërinj, ju mund të jeni të pushtuar nga madhështia e pushtetit, sepse pushteti të deh, veçse dini se jeni shndërruar në shërbëtorë të kreut tuaj, politikat e të cilit janë politika të mirëqenies së shifrave dhe të mjerimit të qytetarëve; dini se ky mjerim i qytetarëve vonon, por nuk harron.

Faleminderit!